



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:172481

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05637768

P.nr. 820/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale ndaj të akuzarit S... F... nga Gjilani, për shkak të veprës penale mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.685/2021 të datës 28.10.2021, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe publike, me datë 03.04.2024 mori, ndërsa me datë 26.04.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri S... F..., nga i ati Muhamet, e ëma B..., e lindur R...i, i lindur me datë 17.10.1961, në fshatin Livoq i Epërm, komuna e Gjilanit, i martuar, baba i katër fëmijëve, i punësuar në Komunën e Gjilanit, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal . shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE

I pandehuri duke qene person–zyrtar-person përgjegjës i Drejtorisë për Kadastër dhe Pronë, në Kuvendin e Komunës në Gjilan, nuk e ka ekzekutuar vendimin gjyqësor Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, me numër AC-1-15-0181-A0001 të datës 12.09.2019, meqë nuk ka bërë bartjen e parcelës kadastrale nr.2142-0 ZK Gjilan, në emër të të dëmtuarit Selami Shkodra me datë 24.10.2010 ka lidhur kontratë me Agjensionin Kosovar të Privatizimit për shitjen e palujtshërisë te evidentuar sipas çertifikatës P-704030013-02142-0 nëpërmes procesit të privatizimit dhe se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme me numër AC-1-15-0181-A0001 të datës 12.09.2019, është vertetuar e drejta e blerjes së paluajshmërisë

nëpërmes procesit të privatizimit, me çrast i pandehuri duke mos ekzekutuar vendimin gjyqësor, tani të dëmtuarit Selami, i ka shkaktuar dëm substancial material.

- Me çka ka kryer veprë penale mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 paragrafi 2 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve: 4, 7, 21, 38, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 paragrafi 1.3, 76 dhe 79, të KPRK-së si nenit 365 lidhur me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-së), të pandehurin në fjalë

E GJYKON

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, i **ZËVENDËSOHET** në dënim me gjobë në shumë prej 1.500 (një mijë e pesëqind euro), të cilën shumë duhet ta paguajë duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon që ta paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimin me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€ (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

Pala e dëmtuar me mbrojtësin e tij për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro dhe shumën prej 30 (tridhjetë) euro, për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Rriedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 28.10.2021, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën PP.II.nr.685/2021, kundër të akuzuarit, për shkak të veprës penale mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 paragrafi 2 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Me datë 01.03.2022, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë pas leximit të aktakuzës lëndore nga prokurori i shtetit, i akuzuari, për shkak të veprës penale mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 paragrafi 2 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktin akuzues për të cilën akuzohet dhe se nuk

e ka pranuar fajësinë për veprën penale të pëshkruar si në aktin akuzues, ashtu që gjykata ka vazhduar me statet e tjera të procedurës.

Gjykata ka mbajtur disa seanca gjyqësore publike të shqyrtimit gjyqësor, në prezencë të prokurorit të shtetit, të pandehurit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat

Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim prokurorja e shtetit ka deklaruar se: me provat e administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor në tërësi është vërtetuar bazueshmëria e aktakuzës e cila është e mbështetur në prova thelbësisht të mbështetshme dhe të marra konform dispozitave ligjore të cilat prova dhe dëshmi janë elaboruar në mënyrë të detajuar. Kështu që është vërtetuar se i pandehuri duke qenë person zyrtar-person përgjegjës i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Kuvendi i Komunës në Gjilan nuk e ka ekzekutuar vendimin gjyqësor edhe atë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtin, me nr. AC-1-15-0181-A0001 të datës 12.09.2019, meqë nuk ka bërë bartjen e parcelës kadastrale nr.2142-0 ZK Gjilan, në emër të të dëmtuarit Selami Shkodra dhe përkundër asaj që i dëmtuari Selami Shkodra me datë 24.02.2010 ka lidhur kontratë me Agjensionin Kosovar të Privatizimit për shitblerjen e paluajtshmërisë të evidentuar sipas certifikatës P-704030013-02142-0 nëpërmes procesit të privatizimit dhe se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme AC-1-15-0181-A0001 të datës 12.09.2019, është vërtetuar e drejta e blerjes së paluajtshmërisë, me çrast i pandehuri duke mos ekzekutuar vendimin gjyqësor tani të dëmtuarit Selami, i ka shkaktuar dëm substancial material. Kërkojmë nga gjykata që analizë deklarave të dhëna para kësaj gjykate mos ta bëjë në mënyrë fragmentare dhe të shkëputur prej provave tjera por të njëjtat ti gërshetojnë vete dhe në bazë të tyre të sjellë vendimin meritor sipas ligjit të bazuar në logjikën dhe në kontest të tërësisë së ngjarjes. Prandaj nga këto fakte dhe prova të pa kontestueshme në bazë të së cilave vërtetohet fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale ashtu siç është e përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, deklaroj se qëndroj pranë kësaj aktakuze dhe propozimeve të cilat i përmban e njëjta dhe kërkoj nga Gjykata që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe konform dispozitave ligjore ti shqiptoj dënimin e merituar. Gjithashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që të merr parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese si shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, dashja e të akuzuarit dhe këmbëngulja për kryerjen e kësaj vepre penale duke mos bërë zbatim të vendimit gjyqësor si drejtor në një organ publik, duke dëmtuar imazhin e organit karshi qytetarëve si dhe dëmi i madh i cili është shkaktuar të dëmtuarit Selami Shkodra e që në vazhdimësi po i shkaktohet.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. Sherif Sherifi ka deklaruar se: sa i përket kosumimit të veprës penale ndaj Sali Fazliut i cili me veprimet e tij për shkak të mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ka kryer veprën penale nga neni 394 paragrafi 1 të KPRK-së. Andaj i propozojmë gjykatës në bazë të njëjtave ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit. Me që tani unë këtu gjindem në cilësinë e përfaqësuesit të dëmtuar zotit për sa i përket kërkesës pasuroro-juridike kërkojmë nga gjykata që përveç tjerash ta obligoj të pandehurin që të bëjë regjistrimin e paluajtshmërisë e njësisë kadastrale P- 2142-0 në sipërfaqe 6016 m2 zona kadastrale Gjilan sipas marrëveshjes së mbitrasferimit e pasurisë të paluajtshme e cila është privatizuar nga AKP e po ashtu të obligohet i pandehuri që të zbatoj vendimet gjyqësore veçanërisht aktgjykimin e Gjykatës Supreme me nr. AC-I- 15- 0181-A0001 të datës 12.09.2019 në të cilën është vërtetuar se i dëmtuari Selami Shkodra e ka blerë paluajtshmërinë në proces të privatizimit dhe të njëjtit i mjafton ky titull juridik në mënyrë që të bëjë regjistrimin e paluajtshmërisë dhe shfrytëzimin për 99 vite të paluajtshmërisë më lartë. I dëmtuari Selami Shkodra si rezultat i veprës penale të të pandehurit as sot e kësaj dite nuk mund ta regjistrojë pronën e tij -02142-0 ZK Gjilan, pasi që është tejkaluar cdo afat i mundshëm ligjor për ta aprovuar kërkesën e tij

ashtu edhe për ta refuzuar të njëjtën, duke shkaktuar përveç dëmeve jo-materiale tek i njëjti edhe dëme materiale të cilat po vazhdojnë të shkaktohen çdo ditë. Se i pandehuri ka kryer veprën penale, madje me dashje direkte e dijeni të plotë e vërteton fakti se edhe në seancën e mbajtur me datë 20.03.2024. Tutje nga deklaratimet e të pandehurit është vërtetuar se i njëjti ka qenë në dijeni për vendimin gjyqësor mirëpo sipas vlerësimeve të tij ky aktgjykim nuk është dashur të zbatohet sepse i dëmtuari Selami Shkodra nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë. Pra në bazë të këtij arsytimi nuk i është bërë regjistrimi dhe gëzimi i të drejtës së shfrytëzimit kontraktuar konform marrveshjes. Andaj, duke i pasur parasysh këto besojmë se gjykata do ta shpallë të pandehurin Salih Fazliu fajtor dhe ta dënoj konform dispozitave ligjore.

Mbrojtësi i të akuzuarit Shemsedin Piraj gjatë fjalës përfundimtare të paraqitur me shkrim në mes tjerash ka deklaruar se në bazë të të gjitha provave të administruara mbrojtja pretendon se mund të konkludohet pa mëdyshje se në rastin konkret nuk sajohen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar Sali Fazliu nga Gjilani. Në rastin konkret është fakt se i akuzuari ka punuar në punët dhe detyrat të cilat u potencuan më lartë mirëpo mbrojtja pretendon se nuk ka prova të mjaftueshme për veprën që pretendon akuza. Për mbrojtjen është e qartë se në rastin konkret nuk është refuzuar kërkesa e të dëmtuarit por vetëm është pezulluar kjo kërkesë deri në sigurimin e dokumenteve të domosdoshme. Argumentet të cilat shkojnë në favor të tezës së mbrojtjes se nuk qëndron vepra penale e Mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga neni 394 paragrafi 2 dhe se një pafajësi e tillë është përcjellë gjatë tërë procesit dhe besoj që pas analizës së provave edhe kjo gjykatë do të bindet se nuk ka prova të mjaftueshme për ta shpallur fajtor për veprën që pretendon aktakuza. Thënë shkurt i mbrojturi im në rrethanat në të cilat ka vepruar është treguar shumë i kujdesshëm dhe shumë komunikativ lidhur me kërkesën e të dëmtuarit dhe ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se në rrethanat në të cilat ka vepruar plotësisht ka vepruar konform dispozitave ligjore edhe atë dy ligjeve dhe urdhëresës administrative dhe këto flasin për një qëndrim të drejtë dhe ligjor dhe që janë elemente të rëndësishme të qëndrimit të tij në kryerjen e detyrave të punës. I pandehuri ka kultivuar mardhënie solide dhe komunikimi i tij është i drejtë në suaza ligjore dhe nuk mund të thuhet se i njëjti ka refuzuar të zbatojë vendimin e Gjykatës Supreme pasi që i akuzuari ka dhënë shpjegime tërësisht të bazueshme dhe të mbështetura ligjërisht. Nga të cekurat më lart propozoj që i njëjti të lirohet në mungesë të provave.

I akuzuari Sali Fazliu gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, dhe kërkoj nga gjykata që të më liroj nga akuza sepse unë nuk jam kryerës i kësaj vepre penale sipas aktakuzës lëndore.

Provat e administruara në shqyrtim gjyqësor personale dhe materiale:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar këto prova: dëshmia e dëshmitarit Naser Krasniqi, zyrtar i lartë ligjor në AKP, deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit Selami Shkodra, deklarata e dëshmitarit Sami Hajrullahu, zyrtar policor në Gjilan, deklarata e dëshmitarit Gursel Sherifi zyrtar në AKP në Gjilan, deklarata e dëshmitares Valbona Bajrami, udhëheqëse e sektorit të Kadastrit, marrveshja për transferrin të pasurisë së paluajtshme e Agjensionit Kosovar të Privatizimit P.nr.203/2010 e dates 24.02.2020, Certifikata e Agjensionit Kadastral të Kosovës P-70403013-02142-0 e lëshuar me date 09.06.2015, Aktgjykimi i Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjensinë Kosovare të Privatizimit, C-III-14-0077 të dates 07.08.2015, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AC-1-15-0181-A0001 i dates 12.09.2019, skica nr.2142-0, formulari për kërkesë apo ankesë menr. Protokollit 10-462/01-0064397/20 të datës 06.08.2020, njoftimi i gjeodetëve për Drejtorinë Rajonale të Policisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Gjilan i datës 10.06.2021,

skicë identifikimi në vendin e ngjarjes, parcela kadastrale nr. 21, aktvendimi për pezullim të përkohshëm të procedurës lëshuar nga Zyra Kadastrale Komuna Gjilan, me date 02.03.2021, kërkesa për sqarim interpretim të marrëveshjes për transferim të pasurisë së paluajtshme Pr.nr.2023/2010 të 24.02.2010 lëshuar me date 20.10.2020, njoftimi për urgjencë lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Gjilan i datës 30.11.2020, Përgjigjja e Agjensisë Kosovare të Privatizimit në kërkesën e datës 21.10.2020, Referenca e AKP-së nr.11121/20-In, deklarata e të dëmtuarit Selami Shkodra e dhënë në Prokurori me date 02.09.2021, deklarata e dëshmitarit Naser Krasniqi e dhënë në Prokurori me datë 17.09.2021 dhe deklarata e të pandehurit Sali Fazliu e dhënë në Prokurori me date 03.09.2021.

Konstatimet e Gjykatës

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik dhe dëgjimit të dëshmitarëve dhe procedimit të provave formale e materiale, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se është provuar se i akuzuari Sali Fazliu nga Gjilani, ka kryer veprën penale mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga neni 394 paragrafi 2 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga marrëveshja për transferim të pasurisë së paluajtshme e Agjencionit Kosovar të Privatizimit P.nr.203/2010 e dates 24.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se palët AKP dhe Selami Shkodra kanë lidhur marrëveshje me datën 24.02.2010.

Nga Certifikata e Agjencionit Kadastral të Kosovës P-70403013-02142-0 e lëshuar me date 03.09.2021, gjykata vërtetoi faktin se parcela P-70403013-02142-0 me sipërfaqe 6016 është e regjistruar në regjistrin e fletëparaqitjeve nr.92/2005;

Nga Aktgjykimi i Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjensinë Kosovare të Privatizimit, C-III-14-0077 të dates 07.08.2015, gjykata vërtetoi faktin se padia e paditëses/kundërpaditurës, Komuna e Gjilanit dhe kundërpadia e të paditurit/kundërpaditësit, Selami Shkodra refuzohen si të pabazuara.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AC-1-15-0181-A0001 i dates 12.09.2019, gjykata vërtetoi faktin se është vërtetuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK-së C-III-14-0077 i datës 07 gusht 2015.

Nga skica nr.2142-0, gjykata vërtetoi faktin se njësia kadastrale – parcela P-70403013-02142 ka sipërfaqe tekstuale 6016 dhe sipërfaqe grafike 7708.4.

Nga formulari për kërkesë apo ankesë menr. Protokollit 10-462/01-0064397/20 të datës 06.08.2020, gjykata vërtetoi faktin se Selami Shkodra kishte paraqitur kërkesën për bartje.

Nga njoftimi i gjeodetëve për Drejtorinë Rajonale të Policisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Gjilan i datës 10.06.2021, gjykata vërtetoi faktin se gjeodetët kishin dalur në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë identifikimin e parceles kadastrale nr.2142-0 në ZK në Gjilan, e cila evidentohet në emër të P.SH. Kuvendi i Komunës në Gjilan.

Nga skica identifikimi në vendin e ngjarjes, parcela kadastrale nr. 21, aktvendimi për pezullim të përkohshëm të procedurës lëshuar nga Zyra Kadastrale Komuna Gjilan, me date 02.03.2021,

kërkesa për sqarim interpretim të marrëveshjes për transferim të pasurisë së paluajtshme Pr.nr.2023/2010 të 24.02.2010 lëshuar me date 20.10.2020, gjykata vërtetoi faktin se

Nga Përgjigjja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në kërkesën e datës 21.10.2020, Referenca e AKP-së nr.11121/20-In gjykata vërtetoi faktin se AKP i është përgjigjur kërkesës nga DGJKP në Gjilan, për sqarim- interpretim të Marrëveshjes për Transferim të Pasurisë së Paluajtshme Pr.nr.203/2010 të datës 24.02.2010.

Nga deklarata e të pandehurit të dhënë në Prokurori, gjykata ka vërtetuar faktin se I njëti ka dhënë deklaratat e tyre, mirëpo në asnjë moment nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer.

Përmbledhje e deklaratave

I dëmtuari **Selami Shkodra** në cilësi dëshmitarit ka deklaruar se këtë pronë e kemi bler në vitin 2007 ka dal në tender të njëjtën e kemi blerë dhe e kemi bërë pagesën e të njëjtës dhe kjo pronë është bler 740.000 Euro, dhe ky vend gjindet ish ndërmarrja 16 Nëndori, sipërfaqja nuk më kujtohet e kemi blerë prej AKP-së dhe probleme nuk kemi pas, problemet kan lidhur pasi që kam kërkuar barjtjen në emrin tim, Komuna e Gjilanit na ka bërë pengesën për barjtjen e kësaj prone dhe ate prej 15 viteve, dhe çdo herë me kërkesë ju kemi drejtu komunës së Gjilanit, deri më sot ne kemi marr përgjigje pse nuk po bartet kjo pronë, ne ju kemi drejtuar gjitha strukturave për realizimin e të drejtave tona dhe përgjigje nuk kemi mar, AKP-ja nuk është pengesë për bartjen e pronës por komuna e Gjilanit, unë as njëherë nuk kam qenë tani te ky i pandehuri që është në sallë, unë nga kadastri nuk kam mar asnjë vendim pse nuk është bart kjo pronë dhe deri më sot nuk kemi vendim për barjtjen e tërsisë së kësaj prone. Po ashtu ka deklaruar se me sa e di unë ne kemi blerë sipërfaqen prej 62 ari e më shumë por sakt nuk e di. Unë e ndi veten shumë i dëmtuar nga mosregjistrimi i kësaj prone dhe ky dëm është qe 15 vite që nuk mundem me realizu të drejtën time, të them të drejtën mund them që kam ndonjë vendim të gjykatave por nuk më kujtohen. Gjithashtu shtoi se është e vërtetë që kemi bërë kërkesë por përgjigjja ka qenë negative, unë i bashkangjitem ndjekjes penale ndaj Sali Fazliut dhe kam kërkesë pasuroro juridike.

Në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar Naser Krasniqi cili ka deklaruar se mbetem pranë që kam dhënë në prokurori me datë 17.09.2021 si dhe deklaratës që e kam dhënë te gjyqtarja Luljeta Shabani me dt. 22.02.2023, edhe pse deklarata para prokurores të cilën e kam dhënë unë ka qenë e zbehtë për faktin se unë atëherë pas kësaj deklarate kam marrë obligim që do ta shqyrtoj lëndën në tersi të cilën e kam përcjellur gjatë shqyrtimit në Dhomën e Posaqme si në shkallë të parë edhe në të dytën e cila padi është ushtruar nga ana e komunës së Gjilanit dhe ndërkohë i është bashkangjitur edhe kundërpadia e blerësit – ankuesit Selami Shkodra. Po ashtu deklaroi se gjithë çka që kam arritur me konstatu aso kohe unë kam deklaruar në procedurën paraprake gjyqësore dhe mbetem në tërësi pranë saj siç ceka me datë 22.02. 2023, arsyeja pse nuk është regjistruar prona deri më tani në emër të blerësit ka qenë, edhe pse kjo pyetje nuk më takon mua të përgjigjem, unë do ti bëjë konstatimet e mija për cilat kam dyshuar se kanë qenë pengesë për tu shitur ashtu siç është dashtë me u shit dhe për tu regjistruar në librin e kadastrit. Konsideroj se aktvendimi i 2005, nxjerrur nga sektori pronësoro – juridik i komunës së Gjilanit, dhe i zbatuar dy ditë më vonë siç shkruan në certifikatën e pronësisë është prek titullari i pronësisë, këtë mund të sheh edhe gjykata vet, në certifikatën e pronësisë se aktvendimi 550/2005, i dt. 10.06.2005 dhe është zbatuar me datë 13.06.2005, unë dyshoj se kjo ka qenë pengesa për cilën atëherë AKM e ka shit me sipërfaqe jo të saktë, siç ceka më lartë se unë dyshoj se është prek titullari i kësaj prone, ndërmarrja si e tillë ia ka shit pompën Inës së

Zagrebit dhe si e tillë ka qenë pronare e tërësisë të kësaj ndërmarrje, e drejta e pronësisë ka shumë attribute, pronare dhe si e tillë ka mundur të jetë si shfrytëzuese apo pronare për faktin se ato depo të ndërtuara dikur pa leje ndërtimi nuk janë bërë, ndërsa ndërmarrja kur ka paraqitur kërkesë për leje ndërtim është dashtë me pas o drejtën e shfrytëzimit apo drejtën e pronësisë, dhe të gjitha këto kriteret ndërmarrja i ka përmbush edhe sa i përket pompës së derivateve. Po ashtu deklaroi se unë në vitin 2009 kam themeluar marrëdhënie pune, kurse në AKM unë nuk kam punuar, unë theksoj se kjo pronë është pregadit dhe shitur në proces të Likuidimit në Zyrën regjionale të Gjilanit, dhe këtu cekim se nga zyrtaret vendor ka qenë Gursel Sherifi i cili është akoma aty ai mua më ka shqaruar se në këtë ORTOFOTO ndërkombëtare e ka nënvizuar me marker të kuq dhe ka theksuar se 58 ari shiten mashkë me objektet. Procedurës së shitjes gjithëmonë i ka parapri me CD, dhe me skica e fotografi të ndryshme se qka është objekt shitje dhe hapja e këtyre ofertave është bërë në mënyrë solemne dhe është ftuar kryetari i komunës së Gjilanit, në arsyetim të vendimeve të Dhomës së Posaqme të GjS, ku theksohet në përgjigje të AKP-së se të gjitha të drejtat që i ka pas ndërmarrja duhet ti barten edhe blerësit. Gjithashtu shtoi se theksoj se deri në vitin 2009 AKP-ja nuk ka pas njësi të kadastrit në Agjensi, ndërsa AKM nuk ka pas njësi të formuar në kuadër të saj dhe për këtë arsye janë shitur shumë asete me sipërfaqe të për afërte, këtu kisha për të shtuar se blerësi ka qenë i detyruar të bëjë një kërkesë në njësinë e kadastrit në AKP, dhe të njëjtit pa kërkesë nuk mund të dalin në vendin e ngjarjes saktësisht vijën ndarëse dhe pronën e blerë, të gjitha obligimet barten te blerësi për tu marrë si pronar pastaj, kadastrit është i obliguar ti regjistrojë këto prona në komunën kompetente. Në fund deklaroi se në vitin 2005 është ndryshuar titullari e dyshimet e mijë janë aty tek ky aktvendim që e ceka më lartë dhe për këtë arsye është bërë edhe ndryshimi i titullarit dhe e kisha lut gjykatën se ja gjykata e siguron këtë aktvendim se qfarë efekti ka pas ky aktvendim, sepse brenda tri dite ky aktvendim është zbatuar dhe këtu cekim dhe ky aktvendim a ka pas drejtë ankese dhe në çka është bazuar i njëjti.

Në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar Sami Hajrullahu i cili ka deklaruar se nuk kam marr pjesë në kallëzimin penal mirëpo kam punuar në grumbullimin e provave si intervistimin e palëve. Kam intervistuar drejtorin e gjeodezisë i cili ka qenë shumë bashkëpunues, gjatë intervistës me të njëjtin kam kuptuar se ka mospërputhje të sipërfaqes me gjendjen faktike dhe me kontratën që ka ofruar për shitblerje pala e dëmtuar. Unë kam bërë kërkesë në gjeodezi për dalje në vendin e ngjarjes për ta konstatuar gjendjen faktike. Pas grumbullimit të të gjitha provave të njëjtat i kam dërguar në prokurori akoma pa u ngritur kallëzimi penal. Në kontratë nuk më kujtohet saktë por për afërsisht kanë qenë rreth 60 ari ndërsa gjendja faktike është rreth 58 ari. Drejtori më ka njoftu se arsyeja pse nuk e ka bërë bartjen në emër të blerësit ka qenë arsyeja mospërputhja e sipërfaqes dhe gjendja faktike. Po ashtu deklaroi se unë kam vepruar vetëm sipas kërkesës së prokurorisë. Sa më kujtohet mua drejtori më ka thënë se e kam pezulluar të njëjtën mos me u regjistru për shkak të mospërputhjes së sipërfaqes. Gjithashtu deklaroi se se gjeodetët që kanë bërë matjen kanë qenë të Komunës së Gjilanit e në shkresat e lëndës është edhe kërkesa ime që ju kam drejtuar gjeodesisë në kadastër pasi që policia zyrtarisht ju drejtohet organeve të komunës e jo atyre privat dhe unë kam marrë pjesë personalisht kur kanë bërë matjen. Sa e diç unë se gjeometrat e kanë nxjerr një raport për matjen që është bërë dhe mendoj se e njëjta duhet të jetë në shkresa të lëndës dhe të njëjtën ia kam dërguar prokurorisë. Në fund deklaroi se nuk kam njohuri se kjo pronë është regjistru apo jo.

Në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar Gursel Sherifi i cili ka deklaruar se ka qenë në atë kohë në vitin 2007 zyrtar për zhvillimin e ndërmarrjeve shoqërore, kurse tani është udhëheqës i ekipit të privatizimit. Kur është lidhur kontrata në mes blerësit në vitin 2010 përkatësisht më datë 24 shkurt 2010 ka qenë duke punuar në Pro Credit Bank si autoditor i mbrendshëm. Kurse unë jam kthyer në AKP ish AKM në qershor të vitit 2010, katër muaj para se unë të vij është

nënshkruar kontrata në mes blerësit dhe AKP-s. Ne personalisht unë nuk i përcjell zhvillimet e mëvonshme pas dorëzimit të kontratës. Gjithashtu deklaroi se deri vonë unë personalisht nuk kam qenë në dijeni se blerësi ka problem në bartjen e të njëjtës dhe ate para 3-4 viteve kam dëgjuar për një problem të tillë. Unë me blerësin nuk jam takuar asnjëherë pas dorëzimit të kontratës .Unë siq cekta se personalisht nuk jam takuar me të njëjtin por nga kolegët në zyrë kam kuptuar se i njëjti ka probleme me bartjen. Ne e kemi zyrrën e shitjes në Prishtinë e cila në njëfarë forme është aty për të sqaruar problemet që mund të dalin nga kontratat e dorëzuara. Ne si zyre regjionale e ndihmojnë në përgaditjen e dokumenteve të shitjes për tenderat që organizohen nga AKP-ja, kjo është detyra jonë, përtej kësaj detyre nuk nuk shkojmë më tej, në lidhje me shitblerjen zyra jonë në Gjilan nuk është e autorizime të mirret me te. Po ashtu shtoi se të gjitha problemet që mund të lindin mes AKP dhe palëve të treta i kemi zyrtarët ligjor që bëjnë përfaqësimin e AKP në proceset gjyqësore dhe për këtë lëndë sa e di unë e ka përfaqësuar Naser Krasniqi i cili ka dhënë deklaratë këtu në këtë gjykatë sepse ka kërkuar nga unë skjarime. Njëherit deklaroi se përgaditjen e dokumentacioneve e bënë zyra regjionale të AKP ku janë pesë regjione në kuadër të AKP-s që me këtë rast kisha për të shtuar pasiqë unë jam udhëheqës i ekipit të privatizimit nga zyrtarët që janë aty unë njoftohem me dokumentacionin e privatizimit dhe ato i standardizoj. Shtoi se për privatizimin e aseteve patjetër duhet të jetë edhe fleta poseduese nëse ekziston për rastin veq e veq, por ka ndodhë që edhe kemi shitur kur ska pas fletëposeduese . Fleta poseduese dëshmon se ai aset në formën në të cilin është i përketë një pronari apo një përdoruesi. Këto të dhëna sipas fletëposedues nr.6199/2015 e dt.09.06.2015 e në te është 60 ari .16 m2 , mirëpo këtu kisha për të shtuar se ne në kontratë është precizuar sipërfaqja e ofruar për shitje e cila është 5800 m2. Po ashtu deklaroi se në kontratë është cek edhe dokumente shitesë me të cilat në një formë dëshmohet se ndërmarrja ka bërë veprime ligjore në atë tokë për ndërtimin e depove. Kompetent për matjen kanë qenë ekspertat-gjeometrat e komunës, por ne si zyre e kemi pas edhe një ekspert kadastral kurse tash i kemi dy. Unë sa e di dhe dokumentacionin që e kam pa është shitur pasuria prej 58 ari . Kontrata e nënshkruara në mes neve dhe blerësit të njëjtat duhet të regjistrohen në zyrën e kadastrit në zyret përkatëse. Këtu kisha për të shtuar se nuk e di a e keni kontratën origjinal në gjuhën angleze që unë e kam dhe në te shkruan se kontrata e dorëzuar është dhënë me të drejtë jo të regjistruar e qka nënkuptohet se qertifikata pronësore e regjistruar nuk ka qenë në emër të ndërmarrjes. Nuk e di se a ka pasur të ngjashme sikur kjo apo jo të cilat jën dorëzuar më herët. Gjithashu shtoi se kur përgaditen dokumentet shitjes të njëjta dërgohen në zyrën Qendrore në Departamentin juridik në Prishtinë për komente ligjore dhe Departamentit Kadastral për komente kadastrale dhe të gjitha komentet që dalin nga Departamenti Juridik inkorporohen në dokumentet e shitjes, të njëjta shërbejnë edhe për konkludimin e kontratave të shitjes. Interpretimet e zyrës ligjore i kemi para shitjes. Tutje deklaroi se nuk kam njohuri se nga kadastrit të ketë pasur kërkesë dhe unë siq cekta ajo mund ti drejtohet vetëm Zyrës Qendrore e jo neve sepse ne nuk kemi autorizime.

Në cilësi të dëshmitares është dëgjuar Valbona Bajrami e cila ka deklaruar se në atë kohë kam qenë zyrtare ligjore kurse tani jam udhëheqëse në sektorin në kadastrë, me sa më kujtohet mua kërkesa është bërë përmes të autorizuarit av. Sherif Sherifi, dhe pas shqyrtimit të lëndës kemi konstatuar se dokumenti nuk është i kompletum, dhe aktin mbi bazën e cilit do të duhej të bëhet regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit, është marrëveshja për transferim të pasurisë të paluajtshme, P.nr. 203/2010 të dt. 24.02.2010, dhe pas shqyrtimit të kërkesës nga ane e drejtorisë sonë kemi pas dilema dhe pakjartësi rreth asaj se çka përfshin transferimi i pronës, në fillim na është dorëzuar verzioni shqip i marrëveshjes e më vonë kemi kërkuar edhe verzionin anglisht, në të cilën në faqen 10 në tabelën të ndërtesat kanë qenë të shënuara depot dhe zyret me sipërfaqe, ndërsa për njësinë kadastrale është shënuar vetëm numri i njësisë, këtij arsye nga Agjencioni i privatizimit në Gjilan autoriteti i likuidimit NSH në Gjilan, me datë 20.10.2020

kemi kërkuar sqarim interpretim të marrëveshjes për transferimin e paluajtshme lidhur me marrëveshjen në fjalë, lidhur me pa kjarhtësit që i kemi pasur se objekt i shitjes është edhe njësisia kadastrale 2142-0 me sipërfaqe 60.16m²,apo vetëm depot nga AKP kemi pranuar përgjigjen me dt. 03.02.2021, në të cilën thuhet se subjekti i shitjes është depo e materialit ndërtimor në “ Vllaznimi” me parcel nr. 2142-0, në sipërfaqe prej përafërisht 5800m²,këtë pasuri nuk e kemi regjistruar në emër të blerësit, sepse ka qenë mos saktësimi i sipërfaqes, pasi që në kadastër regjistrohën pronat me sipërfaqe të caktuar e jo të përafërta, lidhur me këtë e kemi njoftuar palën Selami Shkodrën av. Sherif Sherifi që e kemi thirrur dhe e kemi njoftuar për arsyen mos regjistrimit të njëjtës, i kemi rekomanduar që të parashtrroj kërkesë në sektorin e gjeodezisë fillimisht për krijimin e sipërfaqes të caktuar sipas marrëveshjes, pasi që në drejtorinë tonë në evidencën kadastrale pasuria evidentohet në sipërfaqe 60 ari .16 m². Po ashtu ka shtuar se unë në atë kohë kam qenë përgjegjëse për me u regjistru kjo pronë në emër blerësit, kisha për të shkjaruar se ne si drejtori kemi bërë pezullimin e përkohshëm të procedurës me aktvendim, dhe i rekomandu palët se në afat ligjor prej 30 ditëve, me bërë plotësimin e kërkesës me veprim tjetër procedural i cili duhet të ndërmerret për mes parashtrimit të kërkesës në DGJKP konkretisht në sektorin e gjeodezisë për krijimin e njësisive të reja si të objekteve depove ashtu edhe të sipërfaqes prej 5800 m², kërkesa në kadastër nga ana e palës është dorzuar me dt. 07.08.2020 për regjistrim të drejtës së shfrytëzimit qirambajtje për 99 vite. Gjithashtu shtoi se ne nuk kemi pasur për obligim të njëjtën ta zbatojmë, edhe deri më tani e njejta pronë nuk është bartur në emër të Selami Shkodrës, e kjo është bërë për arsye se pala nuk i ka përmbajtur udhëzimeve tona, vendimet që nxirren nga kadastri është përgjegjësi e drejtorit që të i nënshkruaj kurse këtë pezullim e kam nënshkruar unë në njërën anë dhe ate ana e majt si zyrtare përgjegjëse ndërsa në anën e djathtë drejtori, edhe po ta kisha ditur se në vitin 2005-6 prap të njëjtin veprim e kisha ndërmarr sespe sipërfaqja nga atëherë nuk ka ndryshu, kurse unë nuk jam në dijeni se si kjo parcelë në vitin 2005-6 është parcelizuar. Gjithashtu deklaroi se kontratat janë akte mbi bazën e të cilave bëhet regjistrimi i të drejtave pronësore por vetëm atëherë kur janë të plotësuara me të dhënat si në regjistrat kadastral e jo kur përmbajnë pa rregullësi apo të meta. Tutje deklaroi se nuk jam në dijeni në lidhje me parcelimin që ka ndodhur atëherë, pozita e Sali Fazliut në atë kohë ka qenë UD. i drejtorit të drejtorisë kurse pozita ime ka qenë zyrtare ligjore dhe unë si zyrtare përgjegjëse e lëndës jam konsultuar me drejtorin Sali Fazliun dhe kemi organizuar minimum 3 -4 takime me palën Selami Shkodrën dhe me juve. Në fund shtoi se më dt. 07.08.2020 e kemi pranuar kërkesën për regjistrim gjatë kësaj periudhe deri më dt. 20.10.2020, kemi zhvillu të paktën 3-4 takime- konsulta me parashtruesin e kërkesës Selami Shkodra me përfaqësuesin e tij, po me këtë dt. 20.10.2020 jemi drejtuar Agjensionit të Privatizimit, me kërkesën për sqarim- interpretim të marrëveshjes për transferim të pasurisë së paluajtshme, dhe këtu ka përfunduar veprimi jonë i matutjeshëm në pritje të përgjigjes. Po ashtu deklaroi se parashihet afati 15 ditor në shqyrtimin e lëndës, dhe kur lënda ka parregullsi atëherë i rekomandohet palës për plotësimin e kërkesës me dokumentet relevante për regjistrim, në këtë rast pasi që kërkesa ka qenë jo e kompletume kemi nxjerr vendim të përkohshëm të procedurës me të cilët i kemi rekomanduar palës për veprimet të cilat duhet ti ndërmarr për kompletimin e saj, e ky afat i jepet shtesë palës në afat prej 30 ditësh, e ky afat i dhënë shtesë prej 30 ditësh ne është dashur ta refuzojmë dhe një veprim të tillë nuk e kemi bërë, për arsye se është ngrit kallëzimi penal ndaj drejtorit lidhur me këtë lëndë. Ne jemi të lidhur për ligjin, edhe deri më sot për këtë lëndë nuk kemi refuzuar akoma, e këtë sipas meje nuk e kemi bërë për arsye të kallëzimit penal ndaj drejtorit. Në bazë të ligjit për themelimin e të drejtave të pronave të paluajtshme, të drejtat e paluajtshme regjistrohën në bazë të vendimit të plotëfuqishëm të gjykatës, vendimit të organit administrativ shtetëror, kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuara nga organi kompetent, vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuar nga AKP-ja. Pastaj deklaroi se ka ndodh kur një vendim gjyqësor nuk është përputh ne së pari e kemi njoftuar palën për pa rregullësit e aktit- të metat, ka raste kur

komunikojmë me gjykatën për sqarim të aktgjykimit, në rastin konkret nuk kemi komunikuar me AKP-në, e në rastin konkret ka qenë obligim i shitësit dhe blerësit të komunikojnë në mes vet, sa i përket përgjegjësisë në mes të gjeodetëve dhe drejtorisë tonë nuk kam përgjigje. Përgjigjen nga AKP e kemi marrë me nr. 314 të dt. 03.02.2021, dhe atë depo me sipërfaqe 1765m² e vendosur në hapsirë prej 5800m², dhe shtojmë se objekt shitje është depo e materialit ndërtimor “ depoja Vllaznimi “me parcelë 2142 në sipërfaqe përafërsisht prej 5800m², dhe është evidente se është përshkruar njësia kadastrale 2142-0 në qertifikatën e pronës të dt. 26maj 2009 ZK Gjilan si dhe ndërtesa mirpo jo e tër sipërfaqja e kësaj ngastre ka qenë pjesë e shitjes, konkretisht siq mund të vërehet në deklaratën e transferit të pronës shihet hapsira e përgjithshme që është dashur ti transferohet blerësit ka qenë rreth 5800m², arsyeja pse nuk kemi vepruar për ta regjistruar pronën sipas AKP është se sipërfaqja në regjistrin kadastral e kësaj njësie është 6016m² e jo 5800m², dhe pas marrjes së përgjigjes nga AKP ne kemi pezulluar lëndën përkohësisht deri në plotësimin e kërkesës, si pas meje aktgjykimi është më i fort se sa marrëveshja.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari Salih Fazliu ka deklaruar se është në njohuri se për çka gjindet në gjykatë, për mos zbatim të një vendimi të Gjykatës Supreme, pala Selami Shkodra iu është drejtuar kësaj drejtorie me kërkesë me shkrim për të zbatuar marrëveshja mbi pronën, të cilën pronë i njejtë e kishte privatizuar, në atë kohë unë isha në cilësinë e UD të drejtorit, kërkesat që vinë drejtori shpërndahen sektorë përkatëse, sektori i kadastrit i gjeodezisë dhe pronë, ato lëndë shpërndahen te zyrtarët përgjegjës, kërkesa e Selami Shkodrës ka qenë me ju regjistruar e drejta e qiramarrjes për 99 vjet të një pjese të parcelës 2142-0 e cila gjindet në Gjilan në sipërfaqe prej 6016m², zyrtarja përgjegjëse e cila është ngarku me këtë lëndë që pas shqyrtimit të kësaj kërkesë më ka njoftuar për të metat e aktit juridik marrëveshja e transferit, arsyetimi i saj ka qenë të dhënat që i disponon drejtoria jon regjistrat kadastral nuk përputhen me sipërfaqen e pronës e cila ka qenë objekt i marrëveshjes ose transferit, unë kam ftuar personalisht me telefon palën Selami Shkodrën për ta informuar rreth të metave në marrëveshje, pala më është përgjigjur se unë e kam avokatin tim dhe me të dua të vij dhe kanë ardhur së bashku me avokatin Sherif, unë e kam ftuar edhe zyrtaren përgjegjëse për gjeodezi që duhet ta bëjë matjen e kemi njoftuar palën se objekt shitëse me AKM-në ka sipërfaqja prej 5800m² kurse në regjistrat kadastral kjo sipërfaqe ka më të madhe prej 1016 m² e kemi udhëzuar palën gojarisht që duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr. 10/19 për matje kadastrale për regjistrim në kadastëri dt. 15.11.2019 nga neni 4 par. 2 ku thuhet kërkesa për matje kadastrale bëhet me kërkesë të pronarit, afat nuk i kemi dhënë por marrëveshje me gojë po, dhe kjo kërkesë nuk është plotësuar nga ana e tyre, ndërkohë na ka ardhë një njoftim nga AKP –ja se kjo pompa e benzinës INA dhe njoftimi na ka ardhë me 10.02.2021 se kjo ndërmarrje ka hyrë në procedurë të likuidimit dhe është duke u pregaditur dosja për shitjen e saj, pasi që kjo pompë gjendet së bashku me këtë parcelë e kemi pezulluar vendosjen regjistrimit përkohësisht – procedura është pezulluar përkohësisht. Tutje ka shtuar se vendimin e gjykatës me nr. AC-I-15-0181- A0001 të dt. 12.09.2019 e kemi pranuar, unë deklaroj se në bazë të këtij aktgjykimi nuk e ka ftuar të drejtën e pronësisë. Po ashtu deklaroi se në drejtorinë e gjeodezisë së komunës së Gjilanit nga dt. 06.04.2009 për punë provuese 3 mujore dhe kam vazhduar tutje, në momentin kur është parashtruar kërkesa nga ana e tyre nuk kam pasur njohuri se ka pas numër të veçant kadastral, pasi që më është paraqitur aktakuza kam ardhur te një gjendje se kjo parcelë e mban një numër 2136-21 në emër të Stankoviq Tonqe Drakutin, mirëpo kjo pronë nuk është regjistruar në grafikë të ne por se tekstualisht është dhe kjo gjendje nuk është ndryshuar asnjëherë. Njëherit deklaroi se ka njohuri se deri në atë kohë e njëjta është evidentuar si arë e klasit të parë dhe sipërfaqja ka qenë e njejtë dhe se jemi të obliguar për ta regjistruar kur përputhen të dhënat nga

titulli juridik në të dhënat kadastrale, por jemi të obliguar me pezulluar procedurën deri sa të kompletohen të dhënat. Po ashtu shtoi se këto të dhënat përputhen me njoftimin me marrëveshjen për transfer, na nuk kemi qenë të obliguar ta regjistrojmë këtë pronë sipas marrëveshjes pa i harmonizuar të dhënat me gjendjen kadastrale, nuk i kemi kërkuar, sipas ligjit është 30 ditë, nëse paraqiten probleme aj afat mund të vazhdohet 45 ditë e ky është maksimumi ligjor dhe ky pezullim deri më sot është aktiv, po ka bazë ligjore që është ende aktiv pezullimi. Në fund deklaroi se ka shkelje porse i kemi dhënë afat palës mi kry matjet mi kriju njësin kadastrale prej 5800 m2 edhe ky obligim është i palës, dhe nuk mendoj se palës të jenë shkel të drejtat, është e vërtetë se une në prezenc të av. Sherif Sherifi, Selami Shkodrës e kam thirr drejtorin e AKP-së zyra regjionale në Gjilan dhe kam kërku zgjidhje, dhe i nejejt më ka thënë se dokumentacioni i kësaj shitje gjendet në Prishtinë në qendër dhe se ata e kanë sektorin e shitjes dhe kadastrit dhe se ata janë të obliguar ta zgjidhin këtë problem.

Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje gjykata konform nenit 7 dhe nenit 361 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-s, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartë cekura që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërjegje i ka vlerësuar çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të till ka nxjerrë përfundim lidhur me faktet konkrete të vërtetuara. Lidhur me veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata gjeti se i akuzuari Salih Fazliu , me dashje direkte ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, meqë veprimet e tij të kundërligjshme u vërtetuan nga deklaratat e dëshmitarëve dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu gjykata vlerëson se i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale me dashje sepse ai ka qenë në dijeni për vendimin gjyqësor qe duhet te zbatohet , por sipas vlerësimeve të tij ky aktgjykim nuk është dashur të zbatohet sepse i dëmtuari Selami Shkodra nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë, po ashtu ashtu rrezikshmëria shoqërore sidomos pasojën e shkaktuar- dëmin tek i dëmtuari **Selami Shkodra i cili nuk mund ta regjistrojë pronën e tij -02142-0 ZK Gjilan**.si dhe nuk ka zbatuar as kerkesen nga **Agjensia Kosovare e Privatizimit i drejtohet me shkrese me date 03.02.2021 Drejtorit te Kadastrit dhe e obligon Drejtorin per Kadaster qe eshte dasht ti transferohet blerësit prona qe ka qen rreth 5800 m2 dhe kjo mund te verehet edhe sipas skices (ortofotos) se pershkruar e cila ka qen edhe pjese e dokumenteve te publikuara te shitjes dhe pjese e kontrates me blersin e ri** edhe këtë shkresë Drejtori Sali Fazliu se ka marr per bazë, dhe perkundër veprimeve te bera nga ana e blersit,si dhe Aktgjykimi i Dhomës së posaqme te Gjykatës Supreme AC-1-15-0181-A0001 të datës 12.09.2019,me që nuk ka bërë bartjen e parcelës kadastrale nr.2142-0 ZK Gjilan,në emer të dëmtuarit Selami Shkodra,edhe përkundër asaj që i dëmtuari Selami Shkodra më datë 24.10.2010 ka lidhur kontratë me AKP,për shitëblerjen e palujtshmeris; te evidentuar sipas qertifikatës P-704030013-02142-0 dhe me Aktgjykimin e dhomës së Posqme të Gjykatës Supreme **nr.AC-1-15-0181-A0001 të datës 12.09.2019** ku është vërtetuar e drejta e blerjes së palujtshmerisë nëpërmes privatizimit,më qrast i pandehuri Sali duke mos ekzekutuar vendimin gjyqësor të dëmtuarit Selami i ka shkaktuar dëm të madh. si rezultat i veprës penale së të pandehurit të lartcekur, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata pati parasysh sjelljen e tij në nivelin e duhur në gjykatore, ndërsa si rrethanë rënduese janë të gjitha elementet e veprës penale që i vihet në barrë kjo për faktin se një gjë e tillë u vërtetua në mënyrë të pa kontestueshme nga dëshmia e të dëmtuarit Selami Shkodra, i cili në mënyrë të qartë bindëse i shpjegoi se problemet kanë lindur pasi që kishte kërkuar bartjen e pronës në emrin e tij dhe se Komuna e Gjilanit i ka bërë pengesën për bartjen e kësaj prone edhe atë prej 15 viteve, duke shtuar se çdo herë me kërkesë i është drejtuar komunës së Gjilanit dhe deri më sot nuk kishin marrë përgjigje se pse nuk po bartet kjo pronë.

Vendimi për ta shpallur të akuzuarin fajtor

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin për veprën penale, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjykata gjeti se i njëjti është përgjegjës dhe fajtor dhe janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale.

Rrethanat mbi bazën e të cilave është shqiptuar dënimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 70 të KPRK-s, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen e të akuzuarit gjatë gjithë procesit gjyqësor, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti, pasojën e shkaktuar ndaj tani të dëmtuarit – Selami Shkodra, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të cilën e ka kryer i akuzuari ngase kemi të bëjmë me vepër penale të rrezikshme nga e cila rrezikohet shoqëria në përgjithësi, dashjen e të akuzuarit dhe këmbëngulja për kryerjen e kësaj vepre penale duke mos bërë zbatim të vendimit gjyqësor si drejtor në një organ publik po ashtu pozita e tij zyrtare.

Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Andaj gjykata duke u nisur nga të gjitha këto i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesëve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi lidhur me kërkesën pasuroro juridike

Vendimi lidhur me kërkesën pasuroro juridike të palës së dëmtuar është bazuar në nenin 457 lidhur me nenin 462 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale, gjykata, duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP, ka obliguar të pandehurin të paguaj shpenzimet e procedurës penale, paushallin gjyqësor si dhe konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të detyroj të pandehurin të paguaj taksën për viktimat e krimit (Ligji nr.08/L-109), të gjitha në afat prej 15

(pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.820/2021
Me datë: 26.04.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Laureta Shala

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.